Kronikë

Berat/ Dy persona i shpëtojnë atentatit në lagjen 'Donika Kastrioti'! 2 vëllezër i qëllojnë me automatik nga makina, dyshohet prishja e pazareve të drogës në Greqi (EMRAT)

Dy shtetas banues në Berat, kanë raportuar në polici për një incident ku dy persona, duke lëvizur me një automjet, kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të tyre në lagjen "Donika Kastrioti", pranë spitalit. Fatmirësisht, nga të shtënat nuk ka pasur persona të lënduar.

Mimoza Sinanaj
2 Janar, 17:48 | **Përditësimi: 3 Janar, 00:47**

Share

BERAT - Dy persona kanë arritur ti shpëtojnë një atentati të mirëfilltë pasditen e 2 janarit 2025, në lagjen „Donika Kastrioti". Antonio Merkaj dhe Apostol Dhëmbi, shokë me njëri tjetrin kanë denoncuar në polici se janë qëlluar me automatik kallashnikov nga një automjet tip Ford i zi ndërsa ishin në lagjen Karburant Merko".

Merkaj dhe Dhëmbi kanë ikur me vrap nga karburanti në drejtim të spitalit, ndërkohë që makina i ka ndjekur nga prapa duke qëlluar me breshëri kallashnikovi në drejtim të tyre.

E ndërsa të dy shënjestrat janë larguar në brendësi të lagjes "Donika Kastrioti", atentatorët janë larguar me shpejtësi nga vendngjarja.

LEXO EDHE:
Shkodër/ Të shtëna me armë zjarri në lagjen Rus, qëllohet 4 herë drejt një makine të parkuar! Autori lëvizte me motor pa targa, policia në vendngjarje

Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se autorët e dyshuar janë dy vëllezërit Fatjon dhe Marko Maloku, edhe ato banues në lagjen "Donika Kastrioti" në Berat. Policia nga ana e saj thotë se i ka identifikuar por nuk jep detaje.

> *'Shtetasit Antonio Merkaj , dhe Apostol Dhëmbi banues në Berat, kanë njoftuar Sallën Operative të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat se dy persona që lëvizën me një automjet kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të tyre, në lagjen "Donika Kastrioti", në afërsi të spitalit. Nga të shtënat nuk ka persona të lënduar.*
>
> *Pas marrjes së njoftimit shërbimet e Policisë dhe grupi hetimor kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe si rezultat i reagimit të shpejtë dhe punës paraprake hetimore është bërë e mundur identifikimin i dy autorëve që kanë qëlluar me armë zjarri por për arsye hetimi nuk mund të bëjmë me dije gjeneralitetet e tyre" informoi sot policia e Beratit.*

Sipas të dhënave, të siguruara nga burime konfidenciale, mësohet se konflikti mes dy grupeve ka nisur në Greqi, për prishje të pazareve të drogës mes tyre.

Janë ngritur pika kontrolli në hyrje-dalje të qytetit dhe po vijon kontrollet në zonë për të kapur autorët.

> *Grupi hetimor në drejtimin e Prokurorisë po punon për zbardhjen e rrethanave dhe dokumentimin ligjor të rastit.', njofton policia.*

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Berat | të shtena me arme | Antonio Merkaj | Apostol Dhembi | donika kastrioti | Fatjon Maloku | Marko Maloku

Komento

Komente

End Duro: 03/01/2025 08:53

Mbiu fara e Malokut edhe ne Berat , filluan vrasje e plagosje e te shtena me arme, pastroni Beratin

Përgjigju

Real: 02/01/2025 20:43

Policia e shtetit duhet te ishte ne gadishmeri te perforcuar per festa? Mire qe nuk parandalon por as po i kap dot keta " trima" me kallash ne mes te qytetit. Jane te koruptuar dhe te kapur vete nga krimi, ky eshte problemi.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH ZONE

Sondazhi i ditës:
Çfarë prisni në vitin 2025?

Punë | Shëndet | Mirëqënia

Lajme të tjera

VIDEO/ Po performonte Stresi, të shtëna me armë në koncertin e mbajtur tek Parku Olimpik natën e ndërrimit të viteve në Tiranë! Në kërkim autori (EMRI)
2 Janar, 12:30

VIDEO/ Nata e ndërrimit të viteve, spektakël fishekzjarresh edhe në Berat
1 Janar, 01:51

Lefter Maliqi 'kartolinë' SPAK-ut: Bëre drejtësi me regji! Bëra sërish padi për bashkinë
31 Dhjetor 2024, 12:18

Berat/ Bën parakalim të gabuar, mjeti humb kontrollin del nga rruga dhe më pas përmbyset, plagosen 3 persona (VIDEO)
31 Dhjetor 2024, 07:42

I riu qëllon me armë në ajër dhe e hedh në lumë, vihet në pranga në Kamëz! Ishte i dehur
29 Dhjetor 2024, 11:14

Atentat ndaj vëllait të të 'fortit' të Bulqizës? Denoncimi i Tërnovës në polici: Më qëlluan me armë! Efektivët gjejnë një motor të djegur
27 Dhjetor 2024, 13:27

Kuçovë/ Shiste ilegalisht kapsolla në dyqanin e saj, nën hetim 52 vjeçarja
27 Dhjetor 2024, 12:18

Pushimet e shqiptarëve për festat e fundvitit, agjentja turistike për Report Tv: Vjena e Budapesti të preferuara! Egjipti më i vizituari këtë vit
25 Dhjetor 2024, 15:50

Besimtarët e krishterë në Berat festojnë Krishtlindjet: Dashuri, begati dhe harmoni në çdo familje
25 Dhjetor 2024, 11:37

VIDEO/ 'Mangalem's Shade', magjia e dritave në lagjen muzeale të Beratit

Mimoza Sinanaj

25 Dhjetor 2024, 09:03

E përditshmja britanike 'Sunday Times': 10 vendet më të mira për t'u vizituar në Shqipëri
23 Dhjetor 2024, 09:52

Polonia regjistron më shumë migrantë në kufi me Bjellorusinë
19 Dhjetor 2024, 16:49

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje